

Vendim nr. 91 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (V) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: VILSON ÇOBANI

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjeve nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe nr. 44/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për dispozitat që kanë parashikuar gjykimin e çështjeve penale dhe civile në dhomë këshillimi.

BAZA LIGJORE: Nenet 22, 23, 35, 36, 37, 41, 42, 59, shkronja “e”, 124 dhe 131 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Shqipërisë në datën 23.03.2021 ka miratuar ligjin nr. 41/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 41/2021*) dhe ligjin nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 44/2021*).

2. Ligji nr. 41/2021 ka parashikuar, ndër të tjera, norma të reja në Kodin e Procedurës Penale (*KPP*), sipas të cilave gjykimi në apel bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh në dhomë këshillimi (*neni 427/a*) dhe shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi (*neni 436/a*). Të njëjtat parashikime janë përcaktuar edhe në Kodin e Procedurës Civile (*KPC*), të shtuara dhe/ose të ndryshuara me ligjin nr. 44/2021, sipas të cilave gjykimi në apel dhe në Gjykatën e Lartë bëhet në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumenteve (*nenet 465/a dhe 482*).

3. Në datën 08.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë me objekt shfuqizimin e ligjeve që kanë ndryshuar në datën 23.03.2021 KPP-në dhe KPC-në lidhur me gjykimin e çështjeve penale dhe civile në dhomë këshillimi. Në datën 25.04.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me informacion, duke parashtruar, ndër të tjera, pretendime ndaj një anëtari të saj.

4. Po kështu, kërkuesi në datën 29.04.2024 ka paraqitur informacion shtesë nëpërmjet të cilit ka argumentuar se kërkesa e tij për shfuqizimin e dispozitave procedurale që parashikojnë gjykimin në dhomë këshillimi është e bazuar, pasi gjykatat shfrytëzojnë këto parashikime, sipas tij, për të kryer veprime korruptive. Kërkuesi e ka lidhur këtë informacion me një rast të denoncuar prej tij për korrupsion dhe shpërdorim detyre ndaj disa funksionarëve të sistemit të drejtësisë. Lidhur me këtë kallëzim, prokurori në datën 03.04.2024 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me argumentin se kërkuesi nuk ka dhënë ndonjë të dhënë, ngjarje ose element konkret dhe të besueshëm që të tregojë ekzistencën e faktit penal. Ky vendim, sipas kërkuetit, është

kundërshtuar prej tij në gjykatë, e cila në datën 08.05.2024 ka planifikuar shqyrtimin në dhomë këshillimi.

5. Në vijim, kërkuesi në datën 02.05.2024 ka sjellë sërish kërkesë të titulluar “Informacion (i përsëritur)”, ku, ndër të tjera, ka bashkëlidhur edhe informacionin e paraqitur në datën 29.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ligjet e kundërshtuara mundësojnë gjykimin e çështjeve penale dhe civile në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen dhe dijeninë e palëve, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes në sallën e gjykimit. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk japin CD-në e regjistrimit audio dhe gjykimet në dhomën e këshillimit nuk zhvillohen me sistemin e regjistrimit audio. Po kështu, ato kanë shpërfillur kërkesat që mos të gjykojnë çështjet e tij për sa kohë ai i është drejtuar ministrit të Drejtësisë, Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjykata nuk ka marrë në konsideratë kërkesën e tij për pezullimin e procedurave të gjykimit të një rastit të denoncuar prej tij, duke qenë se ai ka paraqitur në Gjykatë kërkesë për shfuqizimin e dispozitave procedurale penale dhe civile.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” e 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e

reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa i takon kriterit për legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vë në dukje se në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës individi, si subjekt i kushtëzuar, ka të drejtë të vendosë në lëvizje Gjykatën për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, kur ligji cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë kushtetuese të tij. Thënë ndryshe, individi duhet të provojë para kësaj Gjykate se interesi që i cenohet prej ligjit të kundërshtuar është aktual, real, i drejtpërdrejtë dhe jo hipotetik ose i prezumuar.

10. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e ligjeve që kanë ndryshuar/shtuar dispozitat procedurale penale dhe civile në vitin 2021, duke pretenduar se gjykimi i çështjeve në apel dhe në Gjykatën e Lartë bëhet në dhomë këshillimi, mbi bazë të dokumenteve, pa njoftimin dhe praninë e palëve. Sipas kërkuetit, ky lloj gjykimi i ka cenuar të drejtën e mbrojtjes, pasi tashmë nuk mund të jetë i pranishëm në sallën e gjyqimit dhe po kështu, sipas tij, gjykatat, për shkak të këtij gjykimi, nuk procedojnë me regjistrimin audio të seancave.

11. Nisur nga parashtrimet e kërkuetit, si dhe bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes janë me natyrë përgjithësuese dhe se ai nuk ka dhënë ndonjë argument konkret për të provuar pasojat negative të ardhura ose të pritshme për të drejtat ose liritë kushtetuese të tij nga zbatimi i ligjeve

të kundërshtuara. Thënë ndryshe, kërkuesi nuk ka justifikuar interesin e tij vetjak, real dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i takon argumentit të mosnjoftimit të palëve nga gjykatat, Kolegji vë në dukje se të dyja kodet kanë parashikuar norma të posaçme për njoftimin e tyre, i cili, pavarësisht formës së gjykimit, bëhet jo vetëm me shpallje në ambientet fizike të gjykatës, por edhe me mjete elektronike, si në faqen zyrtare të gjykatës, ashtu edhe në adresat e komunikimit elektronik të palëve. Ndërsa, lidhur me mosregjistrimin me sistem audio të seancave në dhomë këshillimi, Kolegji evidenton se asnjë prej dispozitave procedurale penale dhe civile nuk parashikon kufizime të regjistrimit me sistem audio të seancave gjyqësore për shkak të formës së gjykimit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuesit mbeten të paqarta dhe të pakonkretizuara ndaj, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Gjithashtu, lidhur me argumentet e kërkuesit se për një rast të denoncuar prej tij për të cilin prokuroria ka vendosur mosfillimin e hetimit dhe se gjykata në datën 08.05.2024 ka vendosur të zhvillojë gjykimin në dhomë këshillimi, duke mos marrë në konsideratë pezullimin e gjykimit të çështjes për shkak të paraqitjes së kërkesës për shfuqizimin e dispozitave procedurale penale dhe civile, Kolegji i vlerëson të pamjaftueshme në drejtim të legjitimitetit të kërkuesit për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues sipas objektivit të kërkesës. Në këtë vlerësim, Kolegji mban në konsideratë se procesi në fjalë është në vazhdim edhe ende nuk ka një vendim përfundimtar, i cili të mund të dëshmojë shkeljen e pretenduar nga kërkuesi për shkak të dispozitave të kundërshtuara.

14. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk justifikon interesin e tij të drejtpërdrejtë në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49 të ligjit nr. 8577/2000, ndaj çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.